

ANEKS 4

Për funksionet që financohen me transferta specifike për vitin 2018

1. Konviktet e arsimit parauniversitar

Në transfertën specifike të vitit 2018, disa bashkive i janë akorduar fondet për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë përfshihen: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime.

Shpenzimet për personelin (paga dhe sigurime shoqërore) janë llogaritur mbështetur mbi numrin e punonjësve për secilin konvikt sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 502, datë 16.04.2008, “Për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1710, date 29.12.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 502, date 16.04.2008”, për punonjësit edukative (zëvendës drejtor dhe edukator).

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë para fillimit të vitit buxhetor 2018, duhet të dërgojë në njësitë e vetëqeverisjes vendore gjithë kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me pagat dhe sigurimet shoqërore për konviktet e arsimit parauniversitar.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre konvikteve, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të mbështeten në kuadrin rregullator që ka përdorur Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

2. Qëndrat e Shërbimeve Sociale

Në transfertën specifike të vitit 2018 të bashkive, Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Kuçovë dhe Kukës i janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit shërbyes dhe shpenzime operative për qendrat, “Lira”, Berat, “Balash”, Elbasan, “Shpresa” Shkodër, Vau i Dejës dhe qendrat ditore të fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për bashkitë Kuçovë dhe Kukës.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre qendrave bashkitë Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Kuçovë dhe Kukës do të mbështeten në kuadrin rregullator që përdor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

3. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH)

Në transfertën specifike të vitit 2018 të bashkive është akorduar fondi për funksionin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Ministria e Brendshme duhet t’ju dërgojë bashkive të gjithë dokumentacionin që lidhet me personelin e këtij shërbimi, kuadrin ligjor dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me shërbimin.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

4. Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar

Në transfertën specifike të vitit 2018, njësitë e vetëqeverisjes vendore i janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Në fondet e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar nuk përfshihet arsimi i mesëm profesional.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, para fillimit të vitit buxhetor 2018, duhet të dërgojë në bashkitë përkatëse kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me dosjet personale të punonjësve, pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor, personelin ndihmës të arsimit parauniversitar.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

5. Rrugët rurale

Në transfertën specifike të vitit 2018, njësitë e vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në rrugët rurale.

6. Administrimi i pyjeve

Në transfertën specifike të vitit 2018, njësitë e vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, para fillimit të vitit buxhetor 2018, duhet të dërgojë në bashkitë përkatëse kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me funksionimin e këtij shërbimi, si dhe për pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

7. Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën specifike të vitit 2018, njësitë e vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, para fillimit të vitit buxhetor 2018, duhet të dërgojë në bashkitë përkatëse kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me këtë shërbim.

Gjithashtu, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duhet t'ju dërgoj bashkive të gjithë dokumentacionin që lidhet me personelin, mjetet, asetet dhe të dhëna të tjera që disponon, të cilat janë të lidhura me shërbimin.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.